



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 20, Datë 04.02.2022

MBI

**ECURINË E ZBATIMIT TË OBJEKTIVAVE STRATEGJIKË TË ERE PËR VITIN
2021, SIPAS PLANIT TË MASAVE PËR ZBATIMIN E OBJEKTIVAVE
STRATEGJIKË TË ERE PËR PERIUdhËN 2021 – 2023 SI DHE PËRDITËSIMIN E
PLANIT TE MASAVE PËR OBJEKTIVAT STRATEGJIKË TË ERE-S
PËR VITET 2022 – 2023**

Në mbështetje të nenit 16 dhe 18, të ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 04.02.2022, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 179/4 prot., datë 01.02.2022, “Mbi ecurinë e zbatimit të objektivave strategjike të ERE për periudhën 2021 e në vijim, sipas planit të masave për zbatimin e objektivave strategjike të ERE për periudhën 2021 – 2023, si dhe miratimin e planit të masave për objektivat strategjik të ERE-s të rishikuar për vitet 2022-2023”,

Konstatoi se:

- Me vendimin e bordit të ERE-s nr. 74, datë 12.03.2021, u miratuan Objektivat Strategjikë të ERE-s për vitet 2021-2023. Ky dokument vendos objektivat strategjikë që ERE synon të realizojë brenda një periudhe 3-vjeçare, me qëllim përmbushjen e detyrave ligjore të parashikuara në ligjin nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar dhe ligjin nr.102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar.
- Në vijim, bordi i ERE-s me vendimin nr. 96, datë 06.04.2021, vendosi miratimin e Kalendarit të Masave për zbatimin e Objektivave Strategjike të ERE për periudhën 2021 – 2023.
- Kalendarit i masave për zbatimin e Objektivave Strategjike të ERE ka përcaktuar në mënyrë të qartë targetat, detyrat, afatet si dhe strukturat përgjegjëse të ngarkuara me detyrimin e zbatimit dhe ndjekjes së vazhdueshme të objektivave 3 - vjeçare të ERE-s.
- Në zbatim të parashikimeve të Kalendarit të Masave si dhe pikës 2, të vendimit të bordit të ERE-s, nr. 96, datë 06.04.2021, Drejtoritë Teknike të ERE-s kanë paraqitur analizat e tyre me detyrat e kryera për zbatimin e targetave të vendosura për vitin 2021.

- Rezulton se strukturat e ERE-s kanë përmbushur tërësisht disa nga detyrat e lidhura me targetat e vendosur për vitin 2021 si dhe janë në vijim të punës për përmbushjen e disa prej targetave të vitit 2021 e në vazhdim.
- Duke qënë se një pjesë e detyrave lidhen jo vetëm me punën e bërë nga ERE në kuadër të përmbushjes së targetave, por edhe me ndërveprimin me institucione të tjera, ka lindur nevoja e përditësimit të Kalendarit të Masave me qëllim vijim e punës dhe adresimin e realizimit të detyrave për vitet në vazhdim.
- Kalendarit i Masave i rishikuar, rivendos në afat, disa nga detyrat dhe targetat e planit të masave të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96/2021, me qëllim adresimin e tyre brenda vitit 2023.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të miratojë kalendarin e përditësuar të masave të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) për ndjekjen e zbatimit të objektivave strategjike të ERE për periudhën 2022-2023 (Bashkëlidhur tabela nr.1).
2. Kalendarit i përditësuar i masave, i miratuar në pikën 1 të këtij vendimi, do të jetë objekt vlerësimi dhe rishikimi jo më vonë se data 30 Janar i çdo viti kalendarik, deri në implementimin e plotë të tij.
3. Ngarkohet çdo strukturë e ERE-s për zbatimin e këtij vendimi.
4. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë çdo strukturë të ERE-s për këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Petrit AHMETI